



Përditësim për shtypin

Mirë se vini në informimin javor të Dhomave të Specializuara të Kosovës, ku synojmë t'u ofrojmë gazetarëve informacion të përditësuar mbi zhvillimet e fundit në Gjykatë dhe mundësinë për të bërë pyetje.

Në gjykimin e Hashim Thaçi, Bashkim Smakajt, Isni Kilajt, Fadil Fazliut dhe Hajredin Kuçit lidhur me ndikimin e pretenduar ndaj dëshmitarëve, gjatë javës së shkuar, ekipet e Mbrojtjes së z. Kuçi, Kilaj, Fazliu dhe Thaçi mbyllën paraqitjen e provave të veta, me mirëkuptimin që të lejohen të paraqesin prova shtesë në varësi të vendimit të një apeli. Mbrojtja e Smakajt, më 15 maj njoftoi Trupin Gjykes se për momentin nuk synon të paraqesë prova, por kjo mund të ndryshojë në varësi të rezultatit të apelit.

Në gjykimin *Thaçi dhe të tjerët* lidhur me akuza për krime lufte dhe krime kundër njerëzimit, më 15 maj Trupi Gjykes urdhëroi vazhdimin e paraburgimit të Jakup Krasniqit dhe Kadri Veselit. Trupi Gjykes theksoi se emrat dhe të dhënat e disa dëshmitarëve tejet të ndjeshëm janë nxjerrë për të akuzuarit dhe lirimi i një të akuzuari në dijeni të informacionit të ndjeshëm nuk do të ndihmonte në mbrojtjen efikase të dëshmitarëve, pavarësisht fazës së procesit gjyqësor. Trupi Gjykes rikujtoi më tej se ekziston një atmosferë e vazhdueshme e frikësimit të dëshmitarëve në Kosovë dhe se rreziku i ndërhyrjes, që paraburgimi synon të parandalojë, përfshin edhe orvatjet për t'u hakmarrë ndaj dëshmitarëve që kanë dëshmuar në proces apo orvatjet për t'i motivuar dëshmitarët që kanë dhënë dëshmi që t'i tërheqin dëshmitë e tyre. Sipas Trupit Gjykes këto rreziqe mund të zvogëlohen mjaftueshëm vetëm përmes kornizës së monitorimit të komunikimeve në objektin e paraburgimit të DHS-së.

Më 19 maj, Dhoma e Specializuar e Gjykatës Kushtetuese zgjodhi gjykatësin Vidar Stensland si kryegjykatës për një mandat prej një viti, duke filluar nga 1 qershori 2026. Rregullorja e Punës e Dhomës së Specializuar të Gjykatës Kushtetuese përcakton që çdo vit gjykatësit e Gjykatës Kushtetuese zgjedhin me shumicë absolute një kryegjykatës për përmbushjen e përgjegjësisë të specifikuar pas caktimit nga Kryetarja e Dhomave të Specializuara, për një periudhë njëvjeçare.

